


# ANALIZA E ECURISË SË ÇMIMEVE TË DOMATES DHE KASTRAVECIT TË SERËS NË TREGUN E SHUMICËS TË FIERIT DHE KORÇËS PËR PERIUDHËN 15 JANAR – 15 PRILL




**Çmimet mesatare të shumicës së domates së serës së vendit në tregun e Fierit dhe Korçës, në lek/kg, për periudhën 15 Janar - 15 Prill**




Grafiku në të majtë tregon ecurinë e çmimit mesatar të shumicës së domates së serës së vendit, në tregjet e Korçës dhe Tiranës për periudhën 15 Janar – 15 Prill. Në tregun e Korçës prezenca e domates së vendit është konstante nga Janari deri në mesin e Shkurtit, ndërsa në Fier prezenca e saj është më sporadike. Prodhimi i këtij viti i domates së serës së vendit shfaqet përsëri në muajin Prill, në të dy tregjet. Çmimi i domates së serës së vendit është luhatur rreth vlerës mesatare 83 lek/kg në Janar, 84 lek/kg në Shkurt dhe 151 lek/kg gjatë javës së dytë të Prillit në tregun e Korçës. Çmimi mesatar i domates së serës së vendit në tregun e Fierit është luhatur rreth vlerës 87 lek/kg në Janar, 91 lek/kg në Shkurt, 163 lek/kg në Prill. Çmimi mesatar i domates së vendit është rreth 15.7% më i shtrenjtë në Fier sesa në Korçë, por gjithsesi ajo është shitur mesatarisht edhe 2.4% më lirë në Tiranë sesa në Korçë për periudhën e observuar. Në Prill çmimi i domates rritet afërsisht me 84% në të dy tregjet krahasuar me muajt e mëparshëm. Në përgjithësi tendencat e luhatjet e çmimit janë të njëjta në dy tregjet, gjithsesi luhatjet janë më të thella në tregun e Fierit për këtë produkt. Domatja e vendit është shitur mesatarisht 40% më shtrenjtë në Fier në datat 15 dhe 16 Janar.

**Çmimet mesatare të shumicës së domates së serës së importit në tregun e Fierit dhe Korçës, në lek/kg, për periudhën 15 Janar - 15 Prill**




Grafiku i dytë në të majtë tregon ecurinë e çmimeve mesatare të domates së serës së importit për të njëjtën periudhë. Domatja e importit ka qenë prezente në të dy tregjet pothuajse gjatë gjithë kohës. Çmimi mesatar i domates së importit në Korçë është luhatur rreth vlerës 98 lek/kg në Janar, 101 lek/kg në Shkurt, 125 lek/kg në Mars dhe 163 lek/kg në Prill. Domatet e importit janë shitur mesatarisht 12.6% më lirë në Korçë sesa në Fier. Kjo shpjegohet me praninë e tregut të importit më afër në Korçë (tregu Maqedonas). Diferencat më të larta në çmim janë shënuar në Mars, kur ka pasur edhe një ngritje të konsiderueshme të çmimit të importit të domates në të dy tregjet. Kjo rritje koïncidon me mungesën e domates së vendit në treg. Nëse domatet vendase do të fillonin të tregtoheshin që në Mars ato do të mund të tërhiqnin një marzh të konsiderueshëm fitimi nga domatet e importit. Domatet e importit janë 36.9% më të shtrenjta se ato të vendit në Korçë gjatë periudhës së observuar. Në Fier kjo diferencë ulet në 35.4%.

**Çmimet mesatare të shumicës të kastravecit të vendit, në lek/kg, në tregun e Fierit dhe Korçës për periudhën 15 Janar - 15 Prill**



Grafiku në majtë tregon ecurinë e çmimit mesatar të shumicës së kastravecit të vendit në tregjet e Korçës dhe Fierit për periudhën 15 Janar-15 Prill. Ashtu sikurse duket dhe nga grafiku, kastraveci i vendit nuk ka qenë fare prezent në tregun e Korçës deri në fillim të muajit Prill, ndërsa në tregun e Fierit shfaqet për herë të parë në datën 23 Mars. Çmimi mesatar i kastravecit të shkurtër të vendit është luhatur rreth vlerës mesatare 116 lek/kg në tregun e Korçës. Në tregun e Fierit ky çmim është luhatur rreth vlerës 103 lek/kg në Mars dhe 110 lek/kg në Prill. Kastraveci i shkurtër i vendit është mesatarisht 30% më i shtrenjtë në Fier sesa në Korçë gjatë muajit Prill dhe rreth 9% më i shtrenjtë në Tiranë sesa në Fier gjatë gjithë periudhës së observuar.

**Çmimet mesatare të kastravecit të shkurtër të importit, në lek/kg, në tregun e Fierit dhe Korçës për periudhën 15 Janar - 15 Prill**



Grafiku i dytë në të majtë tregon ecurinë e çmimeve mesatare ditore të kastravecit të shkurtër të importit për të njëjtën periudhë në të dy tregjet. Ashtu sikurse duket dhe nga grafiku kastraveci i importit është prezent gjatë gjithë periudhës në të cilën kastraveci i vendit mungon. Në gjysmën e dytë të Marsit e më tej kastraveci i importit ka pësuar një ulje të konsiderueshme të çmimit deri në nivelin e kastravecit të vendit, si në Fier dhe në Korçë, që përkon pikërisht me hedhjen në treg të kastravecit të vendit javën e fundit të Marsit në këto dy tregje. Edhe këtu oferta sa më e hershme e kastravecit të serës do të mundësonte marzhe më të larta fitimi të tregtarëve dhe shitësve të kastravecit të vendit. Çmimi mesatar i kastravecit të shkurtër të importit në Korçë është luhatur rreth vlerës 179 lek/kg në Janar, 228 lek/kg në Shkurt, 158 lek/kg në Mars dhe 102 lek/kg në Prill. Çmimi i kastravecit të importit në Fier është luhatur rreth këtyre vlerave 173 lek/kg në Janar, 207 lek/kg në Shkurt, 170 lek/kg në Mars, 121 lek/kg në Prill. Duket që kastraveci kompetitiv i importit në Fier do të mund të shitej më mirë dhe të ndryshonte balancat në Korçë në fillim të Shkurtit duke sheshuar çmimet e larta në këtë treg e duke sjellë përfitime konsumatorëve. Rritja e ofertës dhe ulja e mëtejshme e çmimit të kastravecit të vendit në treg pritet të ndikojë në uljen e çmimeve të kastravecit të importit deri në atë pikë ku importi i këtij produkti nuk do të jetë më fitimprurës.



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN

**KONKURRUESHMËRIA**  
E BUJQËSISË SHQIPTARE



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
Ministria e Bujqësisë  
Ushqimit dhe  
Mbrotjtjes së Konsumatorit